

Fjala e Z. Blendi Klosi

Faleminderit Znj. Shehi për ftesën dhe për mundësinë që si ministër i Mirëqenies Sociale, ministri e cila jo prej shumë kohësh ka në përgjegjësinë e saj dhe skemën e sigurimeve shoqërore, apo siç njihet në gjuhën popullore, pensionet, të kem mundësinë, dhe me gjithë kënaqësinë pranova të jem pjesë e këtij paneli, për të folur për skemën e pensioneve në Shqipëri. Kjo skemë ka realisht një hop cilësor në dy vitet e fundit pas reformës së ndërmarrë dhe sidomos në vitin e parë që jemi tani po ndihen realisht efektet e kësaj reforme. Natyrisht, diskutohet me një panel kaq prestigjioz, me pjesëmarrje të partnerëve ndërkombëtarë, evropianë, rajonalë apo më shumë se kaq, për të kuptuar aty ku jemi dhe çfarë duhet të bëjmë.

Në mbledhjen e Bordit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore ne kemi diskutuar realisht për situatën ku ndodhet skema e pensioneve e për të parë se çfarë mund të bëjmë më shumë. Ajo çka është bërë është diçka për t'u përshëndetur dhe realisht do të doja të falënderoja të gjithë ata që u morën me reformën e pensioneve vitin e kaluar. Tani po ballafaqohemi me rezultatet e para të kësaj reforme, por do u bëja thirrje të gjithëve publikisht, nga kjo tribunë, në emër të Qeverisë Shqiptare, të Ministrisë së Mirëqenies Sociale, të institucioneve që përkujdesen për grup moshën e tretë, pra për pensionistët e këtij vendi, e të gjithë skemat e tjera që marrin shpërblim nga grupi i pensionit, të kenë më shumë përkujdesje, sepse nëpërmjet politikave tona ne mund të ndryshojmë kryekëput situatën ku ndodhemi dhe po ashtu të hapim perspektiva të reja për një sistem, i cili realisht ka shumë nevojë për reformim.

Reforma e bërë është hap shumë i rëndësishëm, por patjetër ne duhet të ndryshojmë dhe koncepte të tjera. Këto kanë të bëjnë me kohën e re në të cilën ne jetojmë; me ndryshimet demografike në vendin tonë; me rritjen e shpejtë të numrit të atyre që përfitojnë nga skema e pensionit; me rritjen e jetëgjatësisë së popullit tonë, gjë e cila është për t'u përshëndetur; dhe natyrisht ajo që nuk është për t'u përshëndetur por që ndodh në Shqipëri, ulja gjithmonë e më shumë e numrit të lindjeve në vendin tonë. Situata duhet parë me shumë kujdes dhe në disa aspekte, e prandaj them që ajo që ndodhi vitin e kaluar për reformën e sistemit të pensioneve pati disa gjëra pozitive. Së pari, ndaloi hemorragjinë 10-vjeçare, pasi skema vazhdonte të rëndohej në mënyrë eksponenciale, duke shkuar drejt falimentit. Së dyti, vendosi një pension social për moshën e tretë, aq i rëndësishëm për ata, të cilët nuk kanë pasur mundësi që nëpërmjet punës të ishin sot në tregun e pensioneve e të përfitonin pension. E treta, ajo që është më e rëndësishme dhe që ka efekt më afatgjatë, është mundësia e pjesëmarrjes dhe interesi i gjithsecilit për të marrë pjesë në skemën e pensionit.

Në vitin 2014, edhe për faktin e debatit mbi reformën e pensionit, e cila për hir të së vërtetës mund të ishte dhe më i madh, pati realisht një tërheqje vëmendjeje dhe një interesim shumë të madh nga qytetarët lidhur me pensionin që do marrin kur të arrijnë moshën për pension. Pati dhe një numër shumë të madh të cilët u vetë deklaruan. Arritja e vitit 2014 me shtimin e plot 100,000

vetave të rinj në skemën e pensionit, pra kontribues të pensioneve, ishte një arritje spektakolare, e cila dallohet po të shohësh kurbën e pjesëmarrjes së vetë individëve në skemën e pensioneve. Dhe përpjekjet që po ndërmerren sot, përsa i përket luftës kundër informalitetit, janë përpjekje që po ndërmerren në mënyrë që qytetarët vetë të jenë të interesuar të dalin nga skemat e skllavërisë, mos të jenë në tregun e zi, por të regjistrohen dhe të bëhen pjesë kontributive e skemës. Vetëm gjatë muajve gusht-shtator ne kemi me dhjetra mijra, e shifra po shkon në 70,000 njerëz të cilët regjistrohen për herë të parë në skemën kontributive të pensionit.

Thënë të gjitha këto, do të duhet shumë forcë e më shumë përpjekje për të menduar për skema alternative; të mendojmë për skema të cilat nuk më takon mua si ministër që ti shpreh, sepse ju i dini shumë më mirë se unë, por skema të cilat duhet të ndryshojnë kryekëput përjashten e sistemit tonë të pensioneve në realitetin shqiptar. Ne do të duhet patjetër të mendojmë për skemat vullnetare të pensionit, skemat private të pensionit, të cilat nuk mund të jenë tabu vetëm në vendin tonë, por duhet të jetë i njëjti kontribut që ndodh në të gjithë rajonin. Vende si Kroacia, Maqedonia, Bullgaria, Kosova etj., kanë skema shumë të qëndrueshme, të cilat nuk mund të jenë tabu për vendin tonë. Këto duhet të ekzistojnë dhe debati publik, mendimi por shumë më tepër mendimi i ekspertëve e jo i politikanëve do të duhet të na bëjë që të kemi disa problematika, të cilat duhet të zgjidhin problemet; problemet ndërmjet brezave, pasi një problem shumë i madh është se sa brezi i ri është i interesuar për pensionin dhe kjo nuk mund të bëhet me skemën rutinë, por duhet të kemi skema më agresive për ta zgjidhur problemin e brezave. Ndaj, i duhet dhënë një vëmendje shumë e madhe të rinjve dhe tërheqjes së tyre për t'i përfshirë në skemat e pensioneve. Së dyti, siç e thashë më lart, problemi i informalitetit. Nuk mundet vetëm me propagandë qeveritare apo me konferenca shtypi, apo me aksione si ato që kemi ndërmarrë të zgjidhim problemin e informailitetit. Problemi duhet të zgjidhet nëpërmjet skemave, të cilat të na bëjnë të interesuar vetë, çdo qytetar, çdo punëmarrës në realitetin shqiptar të jetë i interesuar të dijë se çfarë është pensioni që do të marrë.

E kam thënë dhe në një konferencë tjetër dhe po përfitoj nga rasti ta them këtu, ne bëhemi shumë sensitivë apo e gjithë shoqëria reagon kur një pensionisti i vidhet pensioni tek dera e postës, por asnjë nga ne nuk reagon kur qindra e qindra fqinjëve tanë, njerëzve tanë, të afërmve tanë punëdhënësi nuk i jep kontributin e pensionit të gjithë jetës. Pra, reagimi që kemi kur vidhet pensioni i një muaji, nuk është fare pjesë e shoqërisë tonë kur i vidhet pensioni i gjithë jetës dhe i mohohet kontributi në të gjithë skemën. Prandaj, po ua them në emër të Qeverisë Shqiptare, në emër të Ministrisë së Mirëqenies Sociale, në emër të ministrit që ka portofolin dhe politikëbërjen për skemën e pensioneve, që duhet më shumë forcë. Ju si përfaqësues të këtij sistemi, ju si njohës të thellë të këtij sistemi, ju si njerëz që e prekni dhe dini shifrat e faktet më mirë se çdokush tjetër, të jemi më të hapur me shoqërinë shqiptare, të jemi më kreativ me shoqërinë shqiptare dhe natyrisht të jemi më përgjegjës për të ardhmen e kësaj skeme në vendin tonë.

Ajo që ka ndodhur në fakt ka shumë tregues pozitivë. Ajo që u bë e mundur nëpërmjet reformës së pensioneve në vitin e kaluar, ka indikatorët e saj të suksesit dhe realisht këtu ne do duhet të jemi krenar për punën e bërë, por dhe për realizimin e atyre çfarë kemi realizuar. Skema e vjetër

e pensioneve, po të vazhdonte ashtu siç kishte nisur, në të ardhmen do të jepte një kolaps të plotë të sistemit. Do të ishte e pamundur që shteti të vazhdonte të mbulonte në mënyra gjithmonë e më shumë të rritura kompensimin për diferencën e vetë skemës. Realizimi i skemës së re, me gjithë problematikat që pati dhe me gjithë, siç e thashë, kërkesën për më tepër për të pasur debat dhe për të korrigjuar aty ku duhet të shkonim, ka realizuar disa tregues pozitiv. Por po të shikojmë çfarë kemi realizuar gjatë vitit të kaluar, shikojmë që diferencat shkojnë gjithmonë e më shumë duke u reduktuar. Për herë të parë në këtë vit, ne kemi një zvogëlim të diferencës ndërmjet asaj që duhet të kontribuojë skema dhe asaj që merr skema në kontribuim. Për herë të parë ne kemi një ulje të kësaj difference dhe po të shikosh shifrat që vijnë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, realisht mund të flasim për rezultate shumë pozitive edhe në vitin e parë të realizimit të skemës së re të pensioneve.

Atë çfarë ne realizuam me ligjin e ri të vitit 2014, kanë qenë disa përmirësime, si ndryshimi i formulës së llogaritjes së pensioneve dhe heqja e tavanit të pensionit maksimal; indeksimi i masës së pensioneve, duke parashikuar vetëm indeksim në masën e inflacionit; njësimin e pagës minimale të kontribuuesve me pagën minimale zyrtare dhe indeksimin e pagës maksimale kontributive me rritjen e rrogës mesatare; rritjen e viteve të kontribuimit për sigurimet shoqërore nga 35 në 40 vjet deri në vitin 2025; rritjen graduale të moshës së daljes në pension për gratë me dy muaj në vit, për ta arritur në 63 vjeç në vitin 2032; rritjen graduale të moshës së daljes në pension për burrat me një muaj në vit, duke e filluar nga viti 2032, dhe barazimi i moshës së daljes në pension për të dyja gjinitë, në 67 vjeç në vitin 2056; përmirësimin e mënyrës së llogaritjes së pensionit për nënat me shumë fëmijë dhe pensionet familjare, duke përcaktuar si moshë për përfitimin e pensionit nga bashkëshorti moshën e daljes në pension; rritjen e normës së kontribuimit për zonat rurale, duke barazuar me kontributet e fermerëve dhe zonës urbane deri në vitin 2017; vendosjen e elementëve dekurajues të daljes në pension të parakohshëm dhe inkurajimin e daljes së mëvonshme në pension; si dhe të drejtën për pension social për individët që nuk patën mundësi që gjatë periudhës së punës të ishin kontributiv në skemën tonë të pensioneve.

Pra, thënë të gjitha këto, dhe padyshim duke mos ju marrë më shumë kohë, unë, në emër të qeverisë shqiptare dhe të Ministrisë së Mirëqenies Sociale, do të jemi kryekëput të interesuar që të marrim çdo lloj reagimi e propozimi që vjen nga ju, ekspertët e fushës. Duke qenë gjithmonë e më shumë të interesuar që për këtë detyrim fisnik që ne kemi për brezin e tretë, për këtë detyrim fisnik që shteti ka për të mbuluar nevojat e njerëzve me aftësi të kufizuara e shtresave të ndryshme në nevojë, atyre që presin dorën e shtetit, atyre që presin kontributet e të gjithë shoqërisë, ne jemi të interesuar të fusim gjithmonë e më shumë skema që ndryshojnë realitetin shqiptar. Ajo që më vjen keq, por e ndjej nga gjithë sistemi i pensioneve në Shqipëri, është një sistem që realisht nuk reagon ashtu si shoqëria shqiptare reagon, një sistem i cili vazhdon të ngelet priturës i kontributeve që vijnë nga vetë individi, por shumë pak bën reformë dhe shumë pak përpiqet vetë që të prodhojë skema, të cilat të kontribuojnë në radhë të parë në buxhetin e pensioneve, në radhë të dytë në rritjen e nivelit ekonomik të vetë pensionistëve, duke rritur në

mënyrë eksponenciale përfitimet financiare që brezi i tretë merr në vendin tonë dhe natyrisht atë që thashë edhe më parë e që për mua është dhe çelësi i gjithë kësaj historie është gjithëpërfshirja. Sa më shumë qytetarë janë të interesuar në përmirësimin e skemës së pensioneve, sa më shumë qytetarët janë vetë të interesuar për momentin kur ata do të dalin në pension dhe sa ne si shoqëri mendojmë për një periudhë më të gjatë sesa dita e nesërme.

Ju Faleminderit!